



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi”, Fakulteti i Arteve Dramatike - Shkup

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë së buxhetit themelor (603) për vitin 2020.

**Qëllimi i revizionit:** Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare të marra në tërësi janë liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- mospajtueshmëria e të dhënave nga evidenca e kontabilitetit dhe bilancit bruto me bilancin e gjendjes;
- regjistrimi është kryer jo i plotë dhe i gabuar i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve me të cilat disponon Fakulteti dhe pajisjeve të pa evidentuara;
- evidentimi jo në kohë dhe kronologjik i faturave të pranuar;
- dobësi të konstatuara te një procedurë e zbatuar të prokurimit publik.

### Mendimi i dhënë \*:

U shprehëm të përmbajtur nga dhënia e mendimit për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2020, ndërsa shprehëm mendim të pavolitshëm për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante.

### Rekomandimet kyçe:

- vendosjen e evidentimit të kontabilitetit në kohë, të plotë dhe kronologjike në librat afariste;
- zbatimin e regjistrimit të plotë dhe evidentimi i të gjitha pajisjeve që nuk janë evidentuar;
- respektimin konsekuent të dispozitave në marrëveshjet e lidhura të prokurimit publik;
- zbatimin e regjistrimit të plotë të mjeteve dhe detyrimeve dhe pajtueshmëria e kontabilitetit me gjendjen faktike;
- Përmirësimin e nivelit të konkurrencës gjatë realizimit të procedurave të prokurimit publik.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Asnjë veprim nga Këshilli Kombëtar nuk është ndërmarrë në lidhje me miratimin e Dekreti për kriteret e financimit të arsimit të lartë, i cili kontribuon në mënyrë të ndryshme të veprimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, nëpërmjet akteve dhe vendimeve që ato i marrin rrjedhimisht.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje te draft-raporti nga ana e Dekanit të Fakultetit.

### Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

pjesa më e madhe e vërejtjeve të dhëna paraqesin njoftime për masat e ndërmarrë pa dorëzim të dëshmimeve shtesë dhe për aktivitetet që janë planifikuar të ndërmerren në periudhën e ardhshme për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

\* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur